<p>përmirësime. Performanca e tij nuk ka ndikim të mjaftueshëm në procesin e sigurimit të cilësisë së shkollës, arritjet dhe përparimin e nxënësve;</p> <p>2.4. Performancë e pakënaqshme - Drejtori/ zëvendësdrejtori i shkollës nuk i plotëson kërkesat bazike të standardeve të praktikës profesionale. Performanca e tij/saj nuk ka fare ndikim në proceset që zhvillohen në shkollë dhe nuk i kontribuon në asnjë formë arritjeve dhe përparimit të nxënësve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Vlerësimi formativ / vjetor i performancës dhe instrumentet e vlerësimit</p> <p>1. Vlerësimi formativ – vjetor, i referohet vetëvlerësimit nga drejtori/ zëvendësdrejtori dhe vlerësimit nga DKA:</p> <p>1.1. Për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë në mandatin e parë në drejtimin e shkollës, vlerësimi formativ- vjetor është i obligueshëm dhe realizohet për çdo vit, për tri vite me radhë;</p> <p>1.2. Për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë në mandatin e dytë të drejtimit të institucionit arsimor, apo në mandate tjera, vlerësimi formativ është i rekomanduar.</p>	<p>improvement. Its performance does not have sufficient influence on the process of quality assurance of the school, students' achievements and progress.</p> <p>2.4. Unsatisfactory performance - The school principal and deputy principal does not meet the basic standards of professional practice standards. His / her performance does not have any impact on the processes that take place at school and does not contribute to any form to the achievement and progress of students.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Formative / Annual performance assessment and Instruments of evaluation</p> <p>1. Formative / annual evaluation is referred to self-evaluation from the principal and deputy principal and evaluation from MED</p> <p>1.1. For principals and deputy principals in the first mandate in school management, formative-annual evaluation is mandatory and is carried out annually each year, for three consecutive years.</p> <p>1.2. For principals and deputy principals in the second mandate of the education institution or other mandates, formative evaluation is recommended.</p>	<p>potreba za poboljšavanje. Njegove performanse nema dovoljan uticaj na proces obezbeđivanje kvaliteta škole, postignuća i napretka učenika.</p> <p>2.4. Nezadovoljavajuća performansa - Direktor/zamenik direktora škole ne ispunjava osnovne zahteve standarda profesionalne prakse. Njegova/njena performansa nema nimalo uticaj na procese koji se odvijaju u školi i ne doprinosi bilo kojem obliku dostignuća i napredak učenik.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Godišnje/formativno vrednovanje performanse i instrumenti ocenjivanje</p> <p>1. Formalna evaluacija - godišnja odnosi se na samoocenjivanje od strane direktora / zamenika direktora i evaluaciju od strane ODO-a.</p> <p>1.1. Za direktore i zamenike direktora u prvom mandatu u upravljanju školom, formativno vrednovanje - godišnje obavezno se sprovodi kroz tri godine zaredom.</p> <p>1.2. Za direktore i zamenike direktora u drugom mandatu upravljanjem obrazovne institucije ili u drugim mandatima, formativno vrednovanje je preporučeno.</p>
--	---	---

<p>2. Procedura e vlerësimit formativ - vjetor:</p> <p>2.1. Përgatitet drafti i planit vjetor të punës nga drejtori/zëvendësdrejtori sipas formularit përkatës;</p> <p>2.2. Organizohet takimi me vlerësuesin e caktuar nga DKA për të diskutuar draftin e propozuar;</p> <p>2.3. Finalizohet plani me objektivat vjetore dhe dorëzohet te vlerësuesi nga DKA;</p> <p>2.4. Bëhet shqyrtimi i objektivave në fillim të periudhës së dytë të mësimit dhe në fund të vitit shkollor;</p> <p>2.5. Bazuar në raportet e shqyrtimit të përmbushjes së objektivave vjetore dhe në intervistën vlerësuese të realizuar nga vlerësuesi i DKA-s, përgatitet raporti i vlerësimit vjetor, sipas instrumentit/formularit përkatës;</p> <p>2.6. Për qëllimet e vlerësimit formativ-vjetor, drejtori/zëvendësdrejtori i institucionit arsimor, çdo vit plotëson formularin e vetëvlerësimit. Në raportin e vetëvlerësimit vjetor evidentohen pikat e forta dhe fushat për përmirësim;</p> <p>3. Detajet rreth realizimit të vlerësimit vjetor</p>	<p>2. The formative –annual evaluation procedure:</p> <p>2.1. The draft annual work plan of the principal / deputy principal is prepared according to the relevant form;</p> <p>2.2. Is organized a meeting with the evaluator appointed by the MED to discuss the proposed draft;</p> <p>2.3. The plan with annual objectives is finalized and is submitted to the evaluator by MED;</p> <p>2.4. The review of objectives is done at the beginning of the second period of learning and at the end of the school year;</p> <p>2.5. Based on the review reports on the fulfilment of the annual objectives and the evaluation interview carried out by the MED evaluator, an annual evaluation report is prepared, according to the relevant instrument / form;</p> <p>2.6. For the purpose of formative-annual evaluation, the principal and deputy principal of the educational institution, each year completes the self-evaluation form. In the annual evaluation report are identified strong points and areas for improvement.</p> <p>3. Details about annual evaluation</p>	<p>2. Procedura formativnog vrednovanja-godišnje.</p> <p>2.1 Priprema se nacrt godišnjeg plana rada od strane direktora / zamenika direktora prema odgovarajućoj formuli</p> <p>2.2. Organiziran je sastanak sa ocenjivačem dodeljen od strane ODO kako bi se razgovaralo o predloženi nacrt.</p> <p>2.3. Plan je finalizovan sa godišnjim objektivima i dostavlja se ocenjivaću iz ODO.</p> <p>2.4. Vrší se razmatranje objektivna na početku drugog perioda učenja i na kraju školske godine.</p> <p>2.5 Na osnovu izveštaja o razmatranju ispunjavanje godišnjih objektivna i intervjuja za ocenjivanje koji je izvršio ocenjivač iz ODO, priprema se godišnji izveštaj o proceni u skladu sa relevantnim instrumentom / obrascem.</p> <p>2.5. Za ciljeve formativne procene - godišnja direktor / zamenik direktora obrazovne institucije, svake godine popunjava obrazac za samo-ocenjivanje. U izveštaju o godišnjem samo-ocenjivanju evidentiraju se čvrste tačke i područja za poboljšanje.</p> <p>3. Detalji o sprovođenju godišnje procene dati</p>
---	--	---

<p>ofrohen në instrumentet/formularët e vlerësimit dhe në udhëzuesin e veçantë për zbatimin e këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Vlerësimi përmbledhës i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit</p> <p>1. I referohet vetëvlerësimit nga drejtori/zëvendësdrejtori, vlerësimit të brendshëm nga DKA dhe vlerësimit të jashtëm nga Inspektorati i Arsimit.</p> <p>2. Fillon të realizohet në fillim të vitit të fundit të ciklit 4 vjeçar të kontratës së punës në pozitën e drejtorit/zëvendësdrejtorit, sipas një plani të hartuar nga Inspektorati i Arsimit në bazë të njoftimit nga DKA sipas nenit 8, pika 1.3.</p> <p>3. Vlerësimi bazohet në burime të shumta informimi të dokumentuara nga të dhënat e mbledhura me instrumentet/formularët sipas nenit 15 të këtij UA.</p> <p>4. Vlerësimi realizohet sipas procedurave të përcaktuara me nenin 16 dhe 17 të këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Kategorizimi në nivelin e përgjithshëm të performancës</p>	<p>implementation are provided in special guideline for implementation of this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 The summative evaluation of the director and the deputy director performance</p> <p>1. It refers to self-evaluation by the principal and deputy principal, internal evaluation by MED and external evaluation by the education inspectorate.</p> <p>2. It starts to be implemented at the beginning of the last year of the 4-year cycle of the employment contract in the position of principal / deputy principal, according to a plan drafted by the Education Inspectorate based on the notification from the MED according to article 8, point 1.3.</p> <p>3. Evaluation is based on numerous resources of information documented from the collected resources with the instruments / forms under Article 15 of this AI.</p> <p>4. Evaluation is carried out according to the procedures set out in Articles 16 and 17 of this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Categorization at the overall performance level</p>	<p>su u instrumentima / oblicima za evaluacije i u specifičnim uputstvima za sprovođenje ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Sažeta procene performanse direktora i zamenika direktora</p> <p>1. Odnosi se na samo-ocenjivanje direktora / zamenika direktora, internu evaluaciju od strane ODO-a i eksterne evaluacije od strane Inspektorata za obrazovanje.</p> <p>2. Počinje da se realizuje se na početak posljednje godine 4 godišnjeg ciklusa ugovora o radu na mesto direktora / zamenika direktora plan sastavljen od strane Inspektorat za obrazovanje na osnovu obaveštenje ODO prema član 8, tačka 1.3.</p> <p>3. Ocenjivanje se zasniva se na brojnim izvorima informacija dokumentovanih iz podataka prikupljenih sa instrumentima / obrascima iz člana 15. ovog AU.</p> <p>4. Ocenjivanje se Realizuje u skladu sa procedurama utvrđenim u članom 16 i 17 ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Kategorizacija opšteg nivoa performanse</p>
--	--	--

<p>1. Niveli i përgjithshëm i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit në bazë të rezultateve nga vlerësimi përmblendhës kategorizohet sipas rezultateve të numrit të pikëve të vlerësimit nga procesi i vlerësimit përmblendhës – vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm.</p> <p>2. Numri maksimal i pikëve të mundshme të fituara gjatë vlerësimit të performancës së drejtorit apo zëvendësdrejtorit është 120 pikë, të cilat mbledhen sipas instrumenteve për vlerësim përmblendhës në nenin vijues të këtij UA.</p> <p>3. Niveli i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit në bazë të rezultateve nga vlerësimi përmblendhës kategorizohet si në vijim:</p> <p>3.1. Performancë e shkëlqyeshme: 108-120 pikë ose 90-100%.</p> <p>3.2. Performancë e mirë: 84 - 107 pikë ose 70-89%.</p> <p>3.3. Performancë e kënaqshme: 60 - 83 pikë ose 50–69%.</p> <p>3.4. Performancë e pakënaqshme: 59 pikë e më pak ose deri në 49%.</p>	<p>1. The overall level of performance of the principal and deputy principal based on the results of the summative evaluation is categorized according to the results of the number of evaluation points from the summative evaluation process - internal evaluation and external evaluation.</p> <p>2. The maximum number of possible points earned during the performance assessment of the principal or deputy principal is 120 points, which are collected according to the instruments for summative evaluation in the following article of this AI.</p> <p>3. The level of performance of the principal and deputy principal based on the results from the summative evaluation is categorized as follows:</p> <p>3.1. Excellent performance: 108-120 points or 90-100%.</p> <p>3.2. Good performance: 84-107 points or 70-89%.</p> <p>3.3. Satisfactory performance: 60-83 points or 50-69%.</p> <p>3.4. Unsatisfactory performance: 59 points or less or up to 49%.</p>	<p>1. Ukupan nivo performansi direktora i zamenika direktora na osnovu rezultata sumativnog ocenjivanja kategorizuje se prema rezultatima broja ocenjivačkih poena iz procesa sumativne evaluacije - interna evaluacija i eksterna evaluacije.</p> <p>2. Maksimalan broj mogućih poena dobijenih tokom ocenjivanja rada direktora ili zamenika direktora je 120 poena, koji se prikupljaju prema instrumentima za sumativno ocenjivanje u sledećem članu ovog AU.</p> <p>3. Nivo performanse direktora i zamenika direktora na osnovu rezultata sumativnog ocenjivanja kategorizuje se na sledeći način:</p> <p>3.1. Odlična performansa; 108-120 poena ili 90-100%</p> <p>3.2. Dobra performansa 84-107 poena ili 70-89%</p> <p>3.3. Zadovoljavajuća performansa 60-83 poena ili 50-69%</p> <p>3.4. Nezadovoljavajuća performansa 59 poena ili manje ili do 49%</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 15 Instrumentet e vlerësimit përmbledhës të performancës</p> <p>1. Vlerësimi i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit realizohet përmes tre instrumenteve/ formularëve zyrtar, të cilët poentohen me pikë:</p> <p>1.1. Instrumenti/Formulari i Vetëvlerësimit të drejtorit/zëvendësdrejtorit (12 pikë ose 10%)</p> <p>1.2. Instrumenti/Formulari i Vlerësimit nga DKA (36 pikë ose 30%).</p> <p>1.3. Instrumenti/Formulari i vlerësimit nga Inspektorati i Arsimit (72 pikë ose 60%).</p> <p>2. Pakoja e instrumenteve për vlerësim të performancës mund të plotësohet, varësisht nga nevojat gjatë zbatimit në praktikë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 The summative evaluation instruments of performance</p> <p>1. The evaluation of the principal and deputy principal performance is realized through three instruments/official forms, which are highlighted with points:</p> <p>1.1. The self-evaluation instrument/form of the principal and deputy principal (12 points or 10%);</p> <p>1.2. The evaluation instrument / form from MED (36 points or 30%);</p> <p>1.3. The evaluation instrument/form from the education inspectorate (72 points or 60%).</p> <p>2. The instruments package for the performance assessment may be completed depending on the needs during implementation in practice.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Instrumenti sažete procene performanse</p> <p>1. Ocenjivanje performanse direktora i zamenika direktora realizuje se kroz tri instrumenta/zvanična formula, koji se boduje poenima</p> <p>1.1. Instrument / obrazac samoocenjivanje direktora / zamenika direktora)12 poena ili 10%;</p> <p>1.2. Instrument/obrazac ocenjivanje od strane ODO (36 poena ili 30%);</p> <p>1.3. Instrument / Obrazac za procenu, od strane Inspektorat za obrazovanje (72 poena ili 60%);</p> <p>3. Paket instrumenata za ocenjivanje performanse može se dopuniti, u zavisnosti od potreba implementacije u praksi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Procedura e realizimit të vlerësimit të brendshëm të performancës – vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga DKA</p> <p>1. Procedura për vetëvlerësim të performancës është si në vijim:</p> <p>1.1. Drejtori/zëvendësdrejtori që i</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 The implementation procedure of the internal performance assessment – self-evaluation and evaluation from MED</p> <p>1. The procedure for self-evaluation of performance is as follows:</p> <p>1.1. The principal / deputy principal</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Procedura realizacije internog ocenjivanja performanse – samoocenjivanje i ocenjivanje od strane ODO</p> <p>1. Procedura za samoocenjivanje performanse je kao u nastavku:</p> <p>1.1. Direktor / zamenik direktora koji</p>

<p>nënshtrahet procesit të vlerësimit përmbledhës të performancës, siguron dhe analizon formularin për vetëvlerësim të performancës;</p> <p>1.2. Sipas nevojës, përgatit pyetësorë për mësimdhënës dhe prindër për të marrë perceptimet/ apo qëndrimet e tyre lidhur me punën e tij/saj dhe i analizon rezultatet e tyre para se të shkruajë raportin e vetëvlerësimit;</p> <p>1.3. Plotëson formularin zyrtar të vetëvlerësimit dhe e nënshkruan atë;</p> <p>1.4. Formularin e vetëvlerësimit, të nënshkruar e dërgon tek vlerësuesi në DKA, në afatin prej shtatë ditësh nga dita e pranimit zyrtar të informatës nga DKA. Kopja e formularit të vetëvlerësimit ruhet në dosjen e drejtorit/zëvendësdrejtorit;</p> <p>1.5. Së bashku me formularin e vetëvlerësimit, drejtori/zëvendësdrejtori që i nënshtrahet procesit të vlerësimit përmbledhës të performancës, vlerësuesit të brendshëm të DKA-s i dërgon edhe formularët e dy viteve të fundit me temat dhe objektivat vjetore dhe vlerësimet për përmbushjen e masave të përcaktuara dhe arritjen e objektivave - sipas formularit 1;</p> <p>1.5.1. Në vitin e parë të zbatimit të këtij UA, drejtorët dhe zëvendësdrejtorët që i</p>	<p>undergoing the summative performance assessment process provides and analyses the performance self-evaluation form;</p> <p>1.2. As needed, prepare questionnaires for teachers and parents to get their perceptions / stances with his / her work and analyses their outcomes before writing a self-evaluation report;</p> <p>1.3. Completes the official self-evaluation form and signs it.</p> <p>1.4. The signed self-evaluation form sends it to the evaluator at the MED within seven days of the official receipt of the information by the MED. A copy of the self-evaluation form is kept in the principal's / deputy principal's file.</p> <p>1.5. Along with the self-evaluation form, the principal / deputy principal undergoing the summative performance assessment process, to the internal evaluator of the MED sends also the forms of the last two years with the annual topics and objectives and the evaluations for the fulfilment of the determined measures and the achievement of the objectives - according to the form 1.</p> <p>1.5.1. In the first year of implementation of this AI, the principals and deputy</p>	<p>podleže proces sažetog ocenjivanja performanse, obezbeđuje i analizira obrazac za samoocenjivanje performanse.</p> <p>1.2. Prema potrebi, pripremite upitnike za nastavnike i roditelje da dobiju njihove percepcije / ili njihove stavove sa njegovim/njenim u vezi rad i analizira njihove rezultate pre pisanja izveštaja o samoocenjivanju.</p> <p>1.3. Popunjava službeni obrazac za samoocenjivanje i to potpisuje.</p> <p>1.4. Obrazac za samoocenjivanje, potpisan, šalje ocenjivaču u ODO u roku od sedam od dana zvaničnog prijema informacije od strane ODO. Kopija obrasca za samoocenjivanje čuva se u dosijeu direktora / zamenika direktora</p> <p>1.5. Zajedno sa obrascem za samoocenjivanje, direktor / zamenik direktora koji podleže proces sažetog ocenjivanja performanse, interni ocenjivači ODO-a dostavlja i obrasce za posljednje dve godine s godišnjim temama i objektivima i procenama za ispunjenje propisanih mera i postizanje ciljeva - prema obrascu 1;</p> <p>1.5.1. U prvoj godini sprovođenja ovog AU direktori i zamenici direktora koji podleže</p>
--	--	---

<p>nënshtrohen vlerësimet përmbledhës të performancës dërgojnë në DKA raportin e vetëvlerësimit dhe planin vjetor të punës së tij/saj së bashku me një raport përmbledhës për realizimin e planit.</p> <p>1.6. Drejtori/zëvendësdrejtori, bën përgatitjet për fazat tjera të vlerësimit përmbledhës të performancës dhe i përgjigjet kalendarit të datave të përcaktuara nga DKA dhe Inspektorati i Arsimit.</p> <p>2. Procedura e vlerësimit të brendshëm të performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit që realizohet nga vlerësuesi i DKA-s është si në vijim:</p> <p>2.1. Vlerësuesi nga DKA harton planin vjetor për realizimin e vlerësimit të brendshëm të performancës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në nivel komune;</p> <p>2.2. Informon drejtorin/zëvendësdrejtorin përkatës me planin e vlerësimit dhe formularin e vetëvlerësimit që duhet plotësuar;</p> <p>2.3. Siguron formularin e vlerësimit të brendshëm dhe bën përgatitjet për procesin e vlerësimit;</p> <p>2.4. Bën takimin e parë konsultativ me drejtorin/zëvendësdrejtorin që vlerësohet</p>	<p>principals undergoing the summative performance assessment send the self-evaluation report and the annual plan of his / her work to the MED together with a summary report for the implementation of the plan.</p> <p>1.6. The principal and deputy principal make preparation for other stages of the performance summary evaluation.</p> <p>2. The procedure for internal performance assessment of the principal / deputy principal performed by the MED assessor is as follows:</p> <p>2.1. MED assessor compiles annual plan for realization of internal performance assessment of principals and deputy principals at the municipal level.</p> <p>2.2. Informs the relevant principal / deputy principal with the evaluation plan and self-evaluation form that needs to be completed.</p> <p>2.3. Provides the internal evaluation form and makes preparations for the evaluation process.</p> <p>2.4. Makes the first consultative meeting with the assessed principal and deputy</p>	<p>zbirnoj proceni performanse šalju ODO-u izveštaj o samoproceni i godišnji njegov/njen plan rada zajedno sa sažetim izveštajem o realizaciji plana.</p> <p>1.6. Direktor / zamenik direktora vrši pripremu za drugu fazu sažetog ocenjivanja performanse i odgovara kalendaru datuma utvrđenim od strane ODO i Inspektorat za obrazovanje .</p> <p>2. Procedura interne evaluacije performanse direktora /zamenika direktora koja se realizuje od strane ocenjivaće iz ODO je kao u nastavku:</p> <p>2.1. Ocenjivač iz ODO sastavlja godišnji plan za realizaciju interne evaluacije performanse direktora i zamenika direktora na opštinskom nivou.</p> <p>2.1. Obaveštava relevantnog direktorom /zamenika direktora planom ocenjivanja i formular za ocenjivanje koji treba da popuni.</p> <p>2.3. Obezbeđuje formular za internu evaluaciju i vrši pripremu za proces ocenjivanje</p> <p>2.4. Obavlja prvi konsultativni sastanak sa direktorom / zamenikom direktora koji se</p>
---	--	---

<p>cakton datën zyrtare të fillimit të procesit të vlerësimit përmbledhës dhe afatin prej shtatë ditësh për pranimin e formularit të plotësuar të vetëvlerësimit dhe formularin me objektivat vjetore për dy vitet e fundit;</p> <p>2.5. Siguron raportin e vetëvlerësimit të drejtorit/zëvendësdrejtorit që i nënshtrohet vlerësimit të performancës, formularin e objektiveve vjetore për dy vitet e fundit dhe vlerësimit për përmbushjen e masave të përcaktuara dhe arritjen e objektiveve – sipas formularit 1;</p> <p>2.6. Sipas nevojës, përgatit pyetësorë për mësimdhënës dhe prindër për të marrë perceptimet/ apo qëndrimet e tyre lidhur me punën e drejtorit/ zëvendësdrejtorit që vlerësohet dhe i analizon rezultatet e tyre para se të shkruajë raportin e vlerësimit të brendshëm;</p> <p>2.7. Plotëson formularin e vlerësimit të brendshëm;</p> <p>2.8. Takohet me drejtorin/ zëvendësdrejtorin e vlerësuar, për t'i diskutuar rezultatet e vlerësimit të brendshëm, brenda 7 ditësh, pas pranimit të formularit të vetëvlerësimit;</p> <p>2.9. Nënshkruan raportin e vlerësimit të brendshëm së bashku me</p>	<p>principal, sets the official start date of the summative assessment process and the seven-day deadline for receiving the completed self-evaluation form and the form with the annual objectives for the last two years.</p> <p>2.5. Provides the self-evaluation form of the principal and deputy principal that is subject to performance assessment, annual objectives form for the last two years and evaluation for the fulfilment of the determined measures and achievement of the objectives - according to Form 1.</p> <p>2.6. If needed, prepares questionnaires for teachers and parents to get their perceptions / attitudes regarding the work of the principal and deputy principal that is assessed and analyses their findings prior to writing the internal evaluation report.</p> <p>2.7. Completes the internal evaluation form.</p> <p>2.8. Meets the assessed principal and deputy principal in order to discuss the results of the internal evaluation within 7 days upon receipt of the self-evaluation form;</p> <p>2.9. Signs the internal evaluation report together with the assessed principal / deputy</p>	<p>ocenjuju i odreduje zvanični datum za početak procesa sažete procene i period od sedam dana za primanje popunjenog obrasca za samoocenjivanje i obrazac sa godišnjim objektivima za poslednje dve godine.</p> <p>2.5. Obezbeđuje izveštaj o samoocenjivanju direktora/zamenika direktora koji je podleže ocenjivanju performanse, obrazac godišnjih ciljeva za poslednje dve godine i procenu za ispunjenje definisanih mera i postizanje objektivna - prema obrascu 1;</p> <p>2.6. Prema potrebi, priprema upitnik za nastavnike i roditelje da bi dobio percepciju/ili njihove stavove u vezi rad direktora/zamenika direktora koji se ocenjuje i analizira njihove rezultate pre pisanja izveštaj o internoj evaluaciji.</p> <p>2.7. Popunjava formu interne evaluacije.</p> <p>2.8. Sastaje se sa ocenjenim direktorom / zamenikom direktora kako bi razgovarali o rezultatima interne evaluacije u roku od 7 dana nakon prijema obrasca za samoocenjivanje;</p> <p>2.9. Potpisuju interni izveštaj o evaluaciji zajedno sa ocenjivanog direktora/zamenika</p>
--	---	---

<p>drejtorin/zëvendësdrejtorin e vlerësuar;</p> <p>2.10. Informon inspektoratin e arsimit për përfundimin e vlerësimit të brendshëm, jo më vonë se tri ditë pas takimit me drejtorin/zëvendësdrejtorin e vlerësuar dhe i dërgon raportet e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të brendshëm tek sektori përkatës i Inspektoratit të Arsimit;</p> <p>2.11. Një kopje e formularit të nënshkruar mbetet në dosjen e drejtorit/zëvendësdrejtorit, një kopje në DKA dhe një kopje dërgohet tek sektori përkatës i Inspektoratit të Arsimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Procedura e realizimit të vlerësimit përmblendhës të performancës – vlerësimit të jashtëm nga Inspektorati i Arsimit</p> <p>1. Planifikimi:</p> <p>1.1. Planifikimi i vlerësimit në shkallë vendi;</p> <p>1.2. Planifikimi i vlerësimit sipas komunave, në konsultim me DKA dhe në bazë të raporteve të vlerësimit të brendshëm të pranuar nga DKA-të përkatëse;</p> <p>1.3. Planifikimi i vlerësimit të performancës së drejtorit dhe të</p>	<p>principal.</p> <p>2.10. Notifies the education inspectorate for completion of the internal evaluation no later than three days after the meeting with the assessed principal and deputy principal and sends the reports of self-evaluation and internal evaluation to the relevant sector of the Education Inspectorate.</p> <p>2.11. A copy of the signed form remains in the principal / deputy principal's file, a copy in the MED and a copy is sent to the relevant Education Inspectorate sector.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 The implementation procedure of the summary performance assessment – internal evaluation from education inspectorate</p> <p>1. Planning:</p> <p>1.1. Planning the evaluation at the country level;</p> <p>1.2. Planning the evaluation according to municipalities, in consultation with MED and based on reports of internal evaluation accepted by respective MEDs;</p> <p>1.3. Planning the evaluation of the principal and deputy principal performance at the</p>	<p>direktora .</p> <p>2.10. Obaveštava Inspektorat za obrazovanje o završetku interne evaluacije najkasnije tri dana nakon sastanka sa ocenjivanim direktorom / zamenikom direktora i šalje izveštaje o samoocenjivanju i internom ocenjivanju sektoru Inspektorata za obrazovanje.</p> <p>2.11. Kopija potpisanog obrasca ostaje u dosijeu direktora / zamenika direktora, jedna kopija u ODO i jedna kopija se šalje od strane ODO relevantnom sektoru Inspektorata za obrazovanje,</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Procedura realizacije sažete procene performanse - eksterna evaluacija od strane Inspektorata za obrazovanje</p> <p>1. Planiranje:</p> <p>1.1. Planiranje procene na državnom nivou.</p> <p>1.2. Planiranje ocenjivanja po opštinama, uz konsultacije sa ODO i na osnovu izveštaja interne evaluacije prihvaćeno od strane relevantnog ODO.</p> <p>1.3. Planiranje ocenjivanja performanse direktora i zamenika direktora na nivou</p>
---	--	--

<p>zëvendësdrejtorit në nivel shkolle.</p> <p>2. Përgatitja për vlerësim:</p> <p>2.1. Njoftimi me shkrim i drejtorit/ zëvendësdrejtorit për procesin e vlerësimit. Njoftimi me shkrim mund të bëhet përmes postës elektronike/e-mail;</p> <p>2.2. Takimi fillestar me drejtorin/ zëvendësdrejtorin për organizimin e procesit të vlerësimit dhe informimi me përmbajtjen e formularit të dokumentimit të punës, si bazë për përgatitjen e portfolios së punës;</p> <p>2.3. Përcaktimi i datës për marrjen e dokumentimit të punës/ portfolios, materialet e së cilës janë objekt i vlerësimit të performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit të institucionit arsimor;</p> <p>2.4. Sigurimi i dokumentimit të punës/ portfolios - planeve, raporteve dhe materialeve të tjera të punës që janë objekt i vlerësimit.</p> <p>3. Procesi i vlerësimit:</p> <p>3.1. Analiza e të dhënave të mbledhura në fazën përgatitore;</p>	<p>school level.</p> <p>2. Preparation for evaluation:</p> <p>2.1. Written notification of the principal and deputy principal for the evaluation process. Written notification can be done through electronic mail/e-mail.</p> <p>2.2. Initial meeting with the principal and deputy principal for organizing the evaluation process and being informed with the content of the work documentation form as the basis for the preparation of the work portfolio.</p> <p>2.3. Setting a date for taking the work documentation, portfolio, whose materials are subject to performance assessment of the school principal and deputy principal of the educational institution.</p> <p>2.4. Provision of work / portfolio documentation - plans, reports and other work materials that are subject to assessment.</p> <p>3. The evaluation process:</p> <p>3.1. Analysis of collected data in the preparatory phase;</p>	<p>škole.</p> <p>2. Priprema za ocenjivanje:</p> <p>2.1. Pismeno obaveštenje direktora / zamenika direktora za proces ocenjivanja. Pismeno obaveštenje se može biti putem elektronske pošte/e-mail</p> <p>2.2. Početni sastanak sa direktorom / zamenikom direktora za organizaciju procesa evaluacije i informisanje sa sadržajem formulara radni dokaz, kao na osnovu pripreme radnog portfolio.</p> <p>2.3. Utvrđivanje datuma preuzimanje radnog dokaza /portfolio, materijali koji su predmet procene performanse direktora škole / zamenika direktora.</p> <p>2.4. Obezbeđivanje radnog dokaza/portfolio - planova, izveštaji ii drugi radni materijali koji su predmet procene.</p> <p>3. Proces evaluacije:</p> <p>3.1. Analiza podataka prikupljenih u pripreмноj fazi</p>
---	--	---

<p>3.2. Rishikimi i instrumentit për intervistë me drejtorin/zëvendësdrejtorin (sipas nevojës – bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura);</p> <p>3.3. Vizitat në shkollë – intervista vlerësuese me drejtorin/zëvendësdrejtorin që vlerësohet;</p> <p>3.3.1. Numri i vizitave vlerësuese në shkollë dhe kohëzgjatja e vizitës përcaktohet nga inspektori i arsimit;</p> <p>3.3.2. Vizitat në shkollë mund të përfshijnë edhe takime me fokus grupe, pyetësorë me përfaqësues të institucionit arsimor, si dhe vëzhgime të situatave praktike të udhëheqjes së takimeve me personel arsimor nga drejtori/zëvendësdrejtori;</p> <p>3.3.3. Për qëllimet e vizitave në shkollë nga pika 3.3.2. e këtij neni, inspektori i arsimit përgatit instrumente përkatëse.</p> <p>3.4. Vizita e parë në shkollë – intervista vlerësuese realizohen më së voni 7 ditë pas sigurimit të planeve e raporteve të punës dhe portfolios së punës që janë objekt i vlerësimit;</p> <p>3.5. Plotësimi i formularit për vlerësim</p>	<p>3.2. Review of instrument for interview with principal/deputy principal (as needed – based on the analysis of the collected data);</p> <p>3.3. School visits – evaluation interviews with principal and deputy principal that is evaluated;</p> <p>3.3.1. The number of evaluated school visits and the duration of the visit is determined by the education inspector;</p> <p>3.3.2. School visits may include meetings with focus groups, questionnaires with representatives of the educational institution, and observations of practical situations of conducting meetings with educational staff from the principal and deputy principal.</p> <p>3.3.3. For the purposes of school visits from point 3.3.2. of this Article, the education inspector prepares relevant instruments.</p> <p>3.4. First school visits - evaluation interviews are realized at the latest 7 days after providing plans and work report and work portfolio that are subject to evaluation;</p> <p>3.5. Completing the form for summative</p>	<p>3.2. Pregled instrumenata za intervju sa direktorom / zamenikom direktora (po potrebi - na osnovu analize prikupljenih podataka).</p> <p>3.3. Posete školi - intervjui za procenu sa direktorom / zamenikom direktora koji se vrednuju.</p> <p>3.3.1. Broj ocenjivakih poseta u školi i trajanje posete određuje inspektor za obrazovanje,</p> <p>3.3.2. Posete školama mogu uključivati i sastanke sa fokus grupama, upitnike sa predstavnicima obrazovne institucije, kao i praćenje praktičnih situacija vođenje sastanaka sa nastavnim osobljem od strane direktora / zamenika direktora.</p> <p>3.3.3. Za potrebe posete školama iz tačke 3.3.2. ovog člana, obrazovni inspektor priprema relevantne instrumente.</p> <p>3.4. Prva poseta školi - intervju za evaluaciju se sprovodi najkasnije 7 dana nakon obezbeđivanje planova izveštaja o radu i portfolio rada koji su predmet evaluacije.</p> <p>3.5. Popunjavanje obrazaca sažetu procenu</p>
---	---	---

<p>përmbledhës të performancës në nivel të standardeve;</p> <p>3.6. Diskutimi i formularit të plotësuar nga vlerësimi i jashtëm dhe i rekomandimeve për përmirësim të performancës;</p> <p>3.7. Nënshkrimi i formularit të vlerësimit të jashtëm nga drejtori/zëvendësdrejtori i institucionit arsimor dhe inspektori i arsimit.</p> <p>4. Raportimi:</p> <p>4.1. Inspektori i arsimit në bazë të formularit të plotësuar për vlerësimin e jashtëm, harton raportin e vlerësimit të jashtëm të performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit të shkollës;</p> <p>4.2. Raporti i prezentohet drejtorit/zëvendësdrejtorit të vlerësuar, nënshkruhet nga inspektori i arsimit dhe drejtori/zëvendësdrejtori i vlerësuar;</p> <p>4.3. Nënshkrimi i raportit nga drejtori/zëvendësdrejtori nuk nënkupton pajtueshmëri, për mospajtueshmëri veprohet sipas nenit 21 të këtij UA;</p> <p>4.4. Raporti u dërgohet: Drejtorit/zëvendësdrejtorit të vlerësuar, shkollës, DKA-s përkatëse dhe arkivit të</p>	<p>performance assessment at the level of standards;</p> <p>3.6. Discussion about the completed form from the external evaluation and recommendations for performance improvement;</p> <p>3.7. Signing the external evaluation form from principal/deputy principal of the education institution and education inspector.</p> <p>4. Reporting:</p> <p>4.1. The education inspector, based on the completed form for external evaluation, drafts the external evaluation report of the performance of the principal / deputy director of the school;</p> <p>4.2. The report is presented to the assessed principal / deputy principal, signed by the Education Inspector and the assessed principal / deputy principal;</p> <p>4.3. The signing of the report by the principal / deputy principal does not mean compliance, for non-compliance is acted according to article 21 of this AI;</p> <p>4.4. The report is sent to: the principal / deputy principal, the school, the relevant MED and the SEI Archive;</p>	<p>performanse na nivo standarde i na ukupnom nivou.</p> <p>3.6. Diskusija o obrascu ispunjenom od strane spoljne evaluacije i preporukama za poboljšanje performanse.</p> <p>3.7. Potpisivanje obrazac o eksternoj evaluaciji od strane direktora / zamenika direktora škole i inspektora za obrazovanje / eksternog ocenjivača.</p> <p>4. Izveštavanje:</p> <p>4.1. Inspektor obrazovanja prema popunjenom obrascu za eksterno ocenjivanje, sastavlja izveštaj o eksternom ocenjivanju performanse direktora/zamenika direktora škole.</p> <p>4.2. Izveštaj se predstavlja ocenjenog direktoru/zameniku direktora, Potpisuje se od strane inspektora za obrazovanje i ocenjenog direktor/zamenika direktora.</p> <p>4.3. Potpisivanje izveštaja direktora/zamenika direktora ne podrazumeva saglasnost, o ne usaglašavanju radi se prema zakonu 21 ovog AU</p> <p>4.4. Izveštaj se dostavlja: Ocenjivanog direktoru/zameniku direktora, školi, relevantnom ODO i arhivi SIO</p>
--	--	--

<p>SIA-s;</p> <p>4.5. Inspektori i arsimit në bazë të raportit të vetëvlerësimit, raportit të vlerësimit të brendshëm nga DKA dhe raportit të vlerësimit të jashtëm nga Inspektori i Arsimit, nxjerr vendim për nivelin e përgjithshëm të performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit të vlerësuar;</p> <p>4.6. Vendimi i inspektorit të arsimit u dërgohet: Drejtorit/zëvendësdrejtorit të vlerësuar, shkollës, DKA-s përkatëse dhe arkivit të SIA-s.</p> <p>4.7. Vendimi për nivelin e përgjithshëm të performancës së drejtorit/ zëvendësdrejtorit, bartet në databazën e licencimit dhe përdoret për të orientuar zhvillimin profesional në udhëheqje dhe menaxhim të institucionit arsimor.</p> <p>5. Detajet rreth realizimit të procedurës së vlerësimit përmbledhës ofrohen në udhëzuesin e veçantë për zbatimin e këtij UA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Rekomandimet për kontratën e punës bazuar në vendimin për nivelin e performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit të vlerësuar</p> <p>1. Lidhur me kontratën e punës bazuar në</p>	<p>4.5. The education inspector, based on the self-evaluation report, the internal evaluation report by the MED and the external evaluation report by the Education Inspector, issues a decision on the overall level of performance of the assessed principal / deputy principal.</p> <p>4.6. The decision of the education inspector is sent to: the principal/ deputy principal, the school, the respective MED and the SIA Archive.</p> <p>4.7. The decision on the overall level of performance of the principal / deputy principal is transferred to the licensing database and is used to guide the professional development in the leadership and management of the educational institution.</p> <p>5. Details about implementation of the summary evaluation procedure are provided in the special guideline for implementation of this AI.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Recommendations for the employment contract based on the decision on the level of performance of the assessed principal / deputy principal</p> <p>1. Regarding the employment contract based on</p>	<p>4.5. Inspektorat za obrazovanje na osnovu izveštaja o ocenjivanju, izveštaju o internoj evaluaciji od strane ODO i i izveštaj o eksternoj evaluaciji od strane Inspektorat za obrazovanje donosi odluku o sve ukupnom nivou performanse ocenjivanog direktora/zamenika direktora</p> <p>4.6. Odluka inspektorata za obrazovanje dostavlja se: Ocenjivanom direktoru/zameniku direktora, školi, dotičnom ODO-u i arhivi SIO</p> <p>4.7. Odluka za opšti nivo performanse direktora/zamenika direktora, se prenosi u bazi podataka o licenciranju i koristi se za orijentaciju profesionalnog razvoja u rukovođenju i menadžiranju obrazovne institucije</p> <p>5. Detalji o sprovođenju procedure sažete procene su dati su u posebnom vodiču za primenu ovog AU.</p> <p style="text-align: center;">Član18 Preporuke za rad zasnovan na odluku o nivou performanse ocenjivanog direktora /zamenika direktora</p> <p>1. U vezi radnog ugovora na osnovu nivoo</p>
--	--	---

<p>nivelin e performancës së treguar nga vlerësimi përmbledhës, aplikohen rekomandimet në vijim: ripërtëritje e kontratës së re të punës për periudhën 4 vjeçare, vazhdim i kontratës së punës për një vit dhe ndërprerje të kontratës së punës.</p> <p>2. Ripërtëritje e kontratës së re të punës për periudhën 4 vjeçare, aplikohet për drejtorin/zëvendësdrejtorin e vlerësuar me performancë të shkëlqyeshme apo me performancë të mirë:</p> <p>2.1. Drejtori/zëvendësdrejtori i vlerësuar me performancë të shkëlqyeshme, mund të angazhohet në cilësinë e mentorit dhe vlerësuesit të brendshëm për drejtorët apo zëvendësdrejtorët fillestar.</p> <p>3. Vazhdim i kontratës së punës për një vit, aplikohet për drejtorin/zëvendësdrejtorin e vlerësuar me performancë të kënaqshme:</p> <p>3.1. Drejtori/zëvendësdrejtori i vlerësuar me performancë të kënaqshme, rekomandohet që të përfshihen në planin për përmirësim të performancës sipas nenit 19 të këtij UA;</p> <p>3.2. Drejtori/zëvendësdrejtori i vlerësuar me performancë të kënaqshme, pas kalimit të planit për përmirësim, i nënshtrohet rivlerësimit të performancës;</p>	<p>the level of performance shown by the summative assessment, the following recommendations are applied: renewal of the new employment contract for a period of 4 years, continuation of the employment contract for one year and termination of the employment contract.</p> <p>2. Renewal of the new employment contract for a period of 4 years, applies to the principal / deputy principal assessed with excellent performance or good performance.</p> <p>2.1. The principal / deputy principal, assessed with excellent performance, can be engaged as mentor and internal evaluator for the beginner principals or deputy principals.</p> <p>3. Continuation of the employment contract for one year is applied for the assessed principal / deputy principal with satisfactory performance.</p> <p>3.1. The assessed principal / deputy principal with satisfactory performance, it is recommended to be included in the plan for performance improvement according to article 19 of this AI.</p> <p>3.2. The assessed principal / deputy principal with satisfactory performance, after passing the improvement plan, is subject to performance reassessment.</p>	<p>pokazane performanse iz sumativnog ocenjivanje primenjuju se sljedeće preporuke: obnova novog radnog ugovora za period od 4 godine nastavak radnog ugovora za jednu godinu i prekid radnog ugovora.</p> <p>2. Obnova radnog novog radnog ugovora za period od 4 godine primenjuje se za direktora/zamenika direktora ocenjenogsa odličnom ili dobroj performansom,</p> <p>2.1. Vrednovan direktor/zamenik direktora sa odličnom performansom, može biti angažovan u svojstvu mentora i internog ocenjivača za nove direktore ili zamenike direktora.</p> <p>3. Nastavak ugovora o radu za jednu. primenjuje se za vrednovanog direktora/zamenika direktora sa zadovoljavajućom performansom.</p> <p>3.1. Direktori i zamenik direktora sa ocenjeni sa zadovoljavajućom performansom, preporučuje se da budu uključeni u plan za poboljšanje ove performanse prema član 18 ovog AU.</p> <p>3.2. Vrednovani direktor/zamnik direktora sa zadovoljavajućom performansom, nakon prelaska plana za poboljšanje podleže</p>
--	--	--

<p>3.3. Rivlerësimi i performancës së drejtorit/zëvendësdrejtorit i vlerësuar me performancë të kënaqshme bëhet me fokus në përmbushjen e rekomandimeve për përmirësim;</p> <p>3.4. Nëse procesi i rivlerësimit konfirmon nivelin e njëjtë të performancës ose më të ulët, ndiqen procedurat sipas paragrafit 4 të këtij neni.</p> <p>4. Ndërprerje të kontratës së punës në pozitën drejtor/zëvendësdrejtor të institucionit arsimor, aplikohet për drejtorin/zëvendësdrejtorin e vlerësuar me performancë të pakënaqshme:</p> <p>4.1. Drejtori/zëvendësdrejtori i vlerësuar me performancë të pakënaqshme, mund ta ushtrojë pozitën udhëheqëse deri në përfundim të procedurave të rekrutimit të drejtorit/zëvendësdrejtorit të ri të institucionit arsimor përkatës, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p>5. Rekomandimet sipas niveleve të performancës së drejtorit/ zëvendësdrejtorit janë të detyrueshme për punëdhënësin.</p> <p>5.1. Në rast të moszbatimit të rekomandimit, punëdhënësi përgatit raport arsyetimi;</p>	<p>3.3. Re-assessment of the performance of the assessed principal / deputy principal with satisfactory performance is done with a focus on meeting the recommendations for improvement.</p> <p>3.4. If the reassessment process confirms the same level of performance or lower, the procedures are followed according to paragraph 4 of this article.</p> <p>4. Termination of the employment contract in the position of principal / deputy principal of the educational institution, is applied for the assessed principal / deputy principal with unsatisfactory performance.</p> <p>4.1. The assessed principal / deputy principal with unsatisfactory performance, may exercise the leading position until the completion of the recruitment procedures of the new principal / deputy principal of the respective educational institution, according to the legal provisions in force.</p> <p>5. Recommendations according to the performance levels of the principal / deputy principal are mandatory for the employer.</p> <p>5.1. In case of non-implementation of the recommendation, the employer prepares a justification report;</p>	<p>ponovnom ocenjivanju performanse;</p> <p>3.3. Ovnova performanse ocenjenog direktora/zamenika direktora sa zadovoljavajućom performansom vrši se usredsređeno na ispunjavanju preporuka za poboljšanje.</p> <p>3.4. Ako proces ocenjivanja potvrdi isti nivo performanse ili niži nivo, sledi se procedura prema stavu 34 ovog člana,</p> <p>4. Prekid ugovora o radu na mesto direktora / zamenika direktora obrazovne institucije primenjuje se za vrednovane direktore/zamenika direktora sa ne zadovoljavajućom performansom.</p> <p>4.1. Vrednovani direktora / zamenika direktora sa ne zadovoljavajućom performansom može da obavlja dužnost do završetka procedure regrutacije novog direktora/zamenika direktora relevantne obrazovne institucije, u skladu sa definisanim zakonom na snazi.</p> <p>5. Preporuke prema nivoima performanse direktora / zamenika direktora su obavezne za poslodavca.</p> <p>5.1. U slučaju neizvršenja, preporuka poslodavac priprema obrazloženje.</p>
--	--	---


